

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çfarë mbeti e paprovuar nga Prokuroria në procesin ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së?
ADRESA	https://albeu.com/kosove/cfare-mbeti-e-paprovuar-nga-prokuroria-ne-procesin-ndaj-kater-i-sh-drejtuesve-te-uck-se/1015572/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:36:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:33:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f186e27bae4fa05a79dbcd3fef232270872ce409239e5bdb27f78658dcdb3409
TEKSTI	b7aeda8bb20c60c1ffb0a461a9cf2677762c33dbe335d29ffb9df80c395b5d89
PAMJA	2ede314db6e13dd172616ad8d284fe8b7963dc8e574e9a15d93442ecfeac4491

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	daa780cfe2b2f0fd08ee75ac54bb26e73c41a46a1f9798534e4c49d807a6f0e3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/daa780cfe2b2f0fd08ee75ac54bb26e73c41a46a1f9798534e4c49d807a6f0e3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Çfarë mbeti e paprovuar nga Prokuroria në procesin ndaj katër ish-drejtnesve të UÇK-së?



Aktgjykimi i shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit solli dënime të rënda, por nuk konfirmoi të gjitha pretendimet e ngritura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Trupi gjyqësor i Dhomave të Specializuara i shpalli katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga gjashtë akuzat që lidheshin me krime kundër njerëzimit.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi morën dënime me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli u dënua me 18 vjet, kurse Rexhep Selimi me 13 vjet. Fajësia e tyre u konstatua për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje, të cilësuar si krime lufte.

Ndryshe përfundoi shqyrtimi i gjashtë akuzave për krime kundër njerëzimit, për të cilat trupi gjyqësor nuk dha vendim fajësie.

Akuzat që nuk u vërtetuan

Aktakuza përfshinte përndjekjen, burgosjen, aktet e tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe zhdukjen e detyruar si forma të krimeve kundër njerëzimit.

Për të provuar këto akuza, nuk mjaftonte që Prokuroria të dëshmonte vetëm kryerjen e vrasjeve, torturave apo ndalimeve të paligjshme. Ajo duhej të vërtetonte përtej dyshimit të arsyeshëm se veprimet ishin pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik të drejtuar ndaj popullatës civile.

Sipas trupit gjyqësor, pikërisht ky kusht themelor juridik nuk u provua nga ZPS-ja.

Kur lexoi përmbledhjen e aktgjykimit, kryetari i trupit gjyqësor, Charles L. Smith, tha se Prokuroria nuk kishte dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të tillë kundër popullatës civile.

të fundit /



Flick mbështet Szczesny pas gafës ndaj Racing...



Deputetët e PD-së shkojnë në Kuvend me stemën e UÇK-së në...



Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, reagon Skënder Geg...



FOTOLAJM/ Deputetët e opozitës ngjisin fotot e Belinda Ballukut m...



Topi i Artë 2026, Mbappe, Yamal, Kane dhe Rodri mes...



Konferenca e Kryetarëve refuzon kërkesën e opozitës ...



Ristoska: Çdo çështje ndaj LSDM-së do ta kisha hapur pa hezitim



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Për rrjedhojë, provat e paraqitura nuk e përmbushën standardin ligjor të nevojshëm që veprimet e konstatuara të klasifikoheshin si krime kundër njerëzimit.

Lirimi nga këto akuza nuk mohon se janë kryer krime

Vendimi për lirimin nga akuzat për krime kundër njerëzimit nuk do të thotë se gjykata arriti në përfundimin se vrasjet, torturat dhe ndalimet nuk kishin ndodhur.

Trupi gjykues çmoi se disa nga këto veprime ishin provuar si krime lufte. Megjithatë, nuk u dëshmuua konteksti juridik më i gjerë që kërkohet për t'i kategorizuar ato njëkohësisht edhe si krime kundër njerëzimit.

Ndryshimi lidhet me kushtet ligjore që duhet të plotësojë secila kategori.

Në rastin e krimeve të luftës, duhet të provohet lidhja ndërmjet veprës dhe konfliktit të armatosur.

Për krimet kundër njerëzimit kërkohet gjithashtu të ekzistojë një sulm i gjerë ose sistematik ndaj popullatës civile dhe të dëshmohet lidhja e veprës me këtë sulm.

Kjo do të thotë se një vrasje ose një akt torture mund të cilësohet si krim lufte, por jo medoemos edhe si krim kundër njerëzimit, nëse Prokuroria nuk provon elementin e sulmit të gjerë ose sistematik.

Procesi nuk kishte në objekt UÇK-në

Gjatë shpalljes së vendimit, gjyqtari Smith sqaroi se çështja gjyqësore trajtonte përgjegjësinë individuale të të akuzuarve. Ajo nuk shqyronte ligjshmërinë e luftës së UÇK-së dhe as përgjegjësinë e organizatës.

Për këtë arsye, përfundimet e trupit gjykues nuk përbëjnë dënim ndaj UÇK-së dhe nuk janë vlerësim kundër luftës çlirimtare të Kosovës.

Gjykata vlerësoi vetëm nëse katër të akuzuarit mbanin përgjegjësi penale individuale për veprat konkrete të renditura në aktakuzë.

Çfarë u provua nga Prokuroria?

Megjithëse gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit nuk qëndruan, trupi gjykues pranoi një pjesë të konsiderueshme të çështjes së paraqitur nga Prokuroria.

Në përmbledhjen e aktgjykimit thuhet se gjykata konstatoi ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal për të shënjestruar persona që konsideroheshin kundërshtarë të objektivave politike ose ushtarake të UÇK-së.

Po ashtu, sipas gjykatës, kishte prova të mjaftueshme për ndalime arbitrare, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur. Dënimet përkatëse u shqiptuan mbi këtë bazë.

Këto konstatime pritet të jenë mes çështjeve kryesore që mbrojtja do të kundërshtojë në apel, sidomos për sa i përket kontributit individual të secilit të dënuar dhe lidhjes së tyre me krimet konkrete.

E drejta e ankimit i takon edhe Prokurorisë

Ky është një vendim i shkallës së parë dhe, si i tillë, ende nuk ka marrë formë përfundimtare.

Mbrojtja ka bërë të ditur se do të paraqesë ankesë, por të njëjtën të drejtë e gëzon edhe Prokuroria. Ajo mund të kundërshtojë konstatimin se nuk u provua një sulm i gjerë ose sistematik i drejtuar kundër popullatës civile.

Eksperti i së drejtës ndërkombëtare Mark Ellis ka vlerësuar se Prokuroria mund të pretendojë se trupi gjykues e ka zbatuar në mënyrë të gabuar kriterin juridik për ekzistencën e një sulmi të tillë.

Në anën tjetër, pritet që mbrojtja të sfidojë përfundimet faktike dhe ligjore përmes të cilave të dënuarit janë lidhur me ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

Në fazën aktuale mund të thuhet se gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit nuk u provuan në shkallën e parë. Sidoqoftë, edhe ky aspekt i aktgjykimit mund të shqyrtohet gjatë procedurës së apelit.

Shënim redaktues: Artikulli bazohet në përmbledhjen publike të aktgjykimit, të lexuar gjatë seancës, si dhe në raportimet mbi vendimin. Aktgjykimi i plotë, në versionin publik dhe të redaktuar, nuk është ende i qasshëm në regjistrin e indeksuar të gjykatës.

Shtuar më 17.09.2026 10:33

Tags: [akuza](#), [gjykimi](#), [Hagë](#), [prokuroria](#)





Pejë, ngrihet aktakuzë për mashtrim në prokurim publik dhe falsifikim...




Altin Krasniqi reagon pas dënimit në Hagë: Na u shua besimi te drejtësia



Aktakuzë ndaj R.K. dhe një personi juridik për keqpërdorim në prokurim...



Dosti bën thirrje për qetësi pas vendimit të Hagës: Ndalni së ndjekuri...



Wesley Clark paralajmëron: Krimet në Kosovë nuk guxojnë të zbehen nga...



Fati i Kuvendit dhe Qeverisë në dorë të Gjykatës Kushtetuese,...



Reagimi i OVL-UÇK-së: Mbledhje dhe konferencë për mediat pas verdiktit t...



25 vite burg për Hashim Thaçin në Hagë/ Djali i ish-presidentit: Lufta ligjore...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.